

Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 paragrafit 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/2019) dhe nenit 40 dhe nenit 41 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme: KSHPK) në vazhdimin e parë të seancës së pesëdhjetë e tetë të mbajtur më 28.12.2021 miratoi

Vendim

Procedura për kontrollimin të fletës anketuese _____, ish -ministër i _____ në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut NDËRPRITET.

Në bazë të dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm të KSHPK-së për lëndën me numër 08-4323/1 datë 16.09.2019.

Lënda me numër 08 -4323/1 të datës 16.09.2019 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 08-4323/1 e datës 16.09.2019 për kontrollimin e fletës anketuese të _____, ish-ministër pa resor në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, është formuar sipas Planit vjetor për përcjelljen e gjendjes pasurore dhe interesave për vitin 2019.

Pas shqyrtimit të evidencës, KSHPK-ja ka konstatuar se personi _____ në afatin e paraparë me ligj prej 30 ditësh pas përfundimit të pozitës së ministrit pa resor në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk ka dorëzuar deklaratë për pronësi dhe konflikt të interesit ne Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe për kundërvajtjen e konstatuar, në pajtim me Ligjin për Kundërvajtje, nuk mund të përgatitet raport për kundërvajtje dhe urdhërpagesë për kundërvajtje.

Të dhënat për të nominuarin dhe familjarët e tij janë kërkuar nga Agjencia për Kadastrën e Pasurive të Paluajtshme, Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e të Ardhurave Publike dhe Depozita Qendrore e Letrave me Vlerë. Njëkohësisht është bërë kontroll në sistemin e shpërndarjes së Regjistrit Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Pas krahasimit të të dhënave të marra me të dhënat e deklaruara në fletën anketuese e të emëruarës, u konstatua se **nuk ka elemente për veprime të mëtejshme në rastin konkret.**

Duke pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.



Përgatiti: Mr. NT-M, Këshilltar
Miratoi: GT, anëtar

КОМИСИОНИ СХТЕТЌОРИ
ПЌР ПАРАНДАЛИМИН И КОРРУПСИОНИТ
КРЈЕТАР,
Biljana Ivanovska